



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep. Nr. I faq. Broj stranica Page No.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No. Data Datum Date
DPK/DPK1 03 03	03-03-91/17 17.01.2017

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	17.01.2017
REFERENC-Ë:	AKK-DPK 03-03/4531/16
PËR/ZA/TO:	z. Ibrahim HOXHA, Menaxher i zyrës së prokurimit në Komunën e Podujevës
CC:	z. Agim VELIU, Kryetar i Komunës së Podujevës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Furnizim me fidane të mjedrës"

I nderuari z. Hoxha ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par.1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin "Furnizim me fidane të mjedrës", me numër prokurimi:615-16-200-111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me monitorimin e procesit rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "Furnizim me fidane të mjedrës", me numër prokurimi: 615-16-200-111, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Podujevës.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 05.12.2016, ka nxjerrë vendim për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull *“Furnizim me fidane të mjedrës”*, me numër të prokurimit: 615-16-200-111, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Podujevës.

Agjencia kundër Korrupsionit duke vepruar sipas detyrës zyrtare me datë 10.01.2017, ka paraqitur njoftimin për pjesëmarrje në monitorim pranë Autoritetit kontraktues, të cilin e ka njoftuar se Agjencia do të marr pjesë në monitorimin e vlerësimit të tenderëve. Agjencia kundër Korrupsionit me datë 12.01.2017, ka marr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në procesin e vlerësimit të tenderëve dhe pasi ka ekzaminuar dhe analizuar tërë dokumentacionin në dispozicion lidhur me këtë procedurë të prokurimit konstaton se, Autoriteti kontraktues ka për synim të lidhë kontratë të furnizimit me fidane të mjedrës për nevojat e Komunës së Podujevës. Për këtë aktivitet të prokurimit, Autoriteti kontraktues ka përdorur procedurën e hapur, duke paraparë kontratë publike furnizimi me vlerë të madhe.

Për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë tërhequr gjithsej **10** Operator ekonomik ndërsa vetëm njëri prej tyre e ka dorëzuar ofertën për këtë kontratë.

Komisioni vlerësues, pasi ka bërë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e kësaj oferte, ka konstatuar se e njëjta nuk është ofertë e përgjegjshme, pasi që nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe kushtet konform dosjes së tenderit. Andaj, komisioni vlerësues në mungesë të ofertave të përgjegjshme i ka rekomanduar Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit që të bëjë anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, ku dhe i njëjti rekomandim është aprovuar nga ZPP.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka marrë pjesë si vëzhgues në vlerësimin e ofertave në lidhje me këtë aktivitet, ka konstatuar se gjatë vlerësimit të tenderëve, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Megjithatë pas analizimit edhe të dokumenteve tjera tenderike, Agjencia kundër Korrupsionit ka vërejtur se vendimi për formimin e komisionit vlerësues është nxjerrë nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, veprim ky i cili nuk është në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik. Sipas LPP-së, vendimin për formim të Komisionit vlerësues është kompetent ta nxjerrë vetëm Zyrtari Kryesor Administrativ i Institucionit e që në rastin tuaj do duhej që një vendim i tillë të propozohej nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dhe të aprovohej nga Kryetari i Komunës si ZKA i Institucionit.

Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit operativ të prokurimit publik i cili është nxjerrë nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe i cili ka hyrë fuqi me datë 01.11.2016, neni 40 pika 1 theksohet se “Duke ju referuar nenit 59 paragrafi 1 i Ligjit për prokurimin publik, për të gjitha aktivitetet e prokurimit, Autoriteti kontraktues respektivisht, Zyrtari Kryesor Administrativ në bashkëpunim të ngushtë me Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit duhet të krijoj një komision të vlerësimit të

tenderëve, me funksione krejtësisht këshilluese për Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit. Nga ky rregull përjashtohen vetëm aktivitetet me vlerë minimale. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit do të bëjë rekomandimin për anëtar të komisionit të vlerësimit të tenderëve për ZKA, i cili do të aprovoj të gjitha nominimet ose kur është e nevojshme do të zgjedh anëtarë alternativ për komisionin.”

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh nenin 59 ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr.04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 dhe nenin 40 pika 1 i Rregullave dhe udhëzuesit operativ të prokurimit publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit kërkon nga Autoriteti kontraktues që në rast të ri-tenderimit të këtij aktiviteti të prokurimit të veprojnë konform Legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe që të mos i përsëris praktikën e tilla në të ardhmen.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !

